



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:250084

Datë: 23.09.2024

Numri i dokumentit: 06193114

KE.nr. 298/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit “Pro Milk Group” Sh.P.K., me nr. të biznesit 70766019 dhe me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Jeton Osmani nga Prishtina, kundër të paditurit “Digit Alb” Sh.A., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Arlind Jupolli nga Prishtina, me objekt kontesti pasurim i pabazë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 23.09.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerçiale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, SHPALLET JO KOMPETENTE në pikëpamje absolute për të vendosur sipas padisë së paditësit “Pro Milk Group” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit “Digit Alb” Sh.A., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë me objekt kontesti pasurim i pabazë.
- II. SHPALLEN TË PAVLEFSHME të gjitha veprimet procedurale të kryera nga gjykata në këtë çështje kontestimore.
- III. HUDHET POSHTË si e palejuar padia paditësit “Pro Milk Group” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit “Digit Alb” Sh.A., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë me objekt kontesti pasurim i pabazë, në mungesë të juridiksionit gjyqësor të gjykatës vendore.

A r s y e t i m

Paditësi “Pro Milk Group” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 28.03.2019 ka paraqitur padi ndaj të paditurës “Digit Alb” Sh.A., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, me objekt kontesti pasurim i pabazë.

Lënda në fjalë, fillimisht ishte trajtuar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike nën shenjën III.EK.nr. 163/19 ashtu që gjykata, kishte marrë veprime duke caktuar seancën përgatitore dhe seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, lënda në fjalë, në bazë të kompetencës lëndore është transferuar pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës dhe ka marrë shenjën KE.nr. 1020/22.

Gjykata, duke filluar rishtazi procedurën në këtë çështje juridike, me datë 19.02.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën përgatitore.

Përgjatë seancës përgatitore, nga përfaqësuesi i të paditurës, është ngritur prapësimi i mungesës së kompetencës lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate për shqyrtimin e çështjes, kjo meqenëse i padituri vie nga Republika e Shqipërisë dhe nuk ka seli dhe as degë të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Andaj gjykata, duke vendosur lidhur me prapësimin e palës së paditur sa i përket mungesës së kompetencës lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, jashtë seancës, në kuptim të nenit 18 të LPK-së vlerësoi kompetencën e saj gjyqësore dhe gjeti se padia e paditësit është e palejuar kjo për shkaqet në vijim:

Me nenin 18 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje si LPK) përcaktohet se “Gjykata, sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore”, ndërsa me nenin 39 par. 2 të po të njëjtit ligj, parashihet që “Për gjykimin në kontestet kundër personave juridik të tjerë e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e të cilës ndodhet selia e tyre e regjistruar”.

Në anën tjetër, me nenin 111, par.1 nën-par 1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr.08/L-028 për të Drejtën Ndërkombëtare Private në lidhje me kompetencën e përgjithshme në procedurë kontestimore parashihet se “Gjykata e Republikës së Kosovës është kompetente nëse i padituri është: 1.1. person fizik i cili ka vendbanim ose vendqëndrim të zakonshëm në Republikën e Kosovës; 1.2. person juridik me seli në Republikën e Kosovës”.

Në ndërlidhje me dispozitat e lartcekura, në rastin konkret gjykata konstatoi që si palë e paditur paraqitet “Digit Alb” Sh.A. me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë. Pra e paditura, nuk evidentohet si subjekt juridik me seli në Republikën e Kosovës dhe e njëjta nuk ka degë të regjistruar në territorin e Republikës së Kosovës. Mbi këtë bazë, meqenëse pala e paditur nuk gëzon seli në territorin e Republikës së Kosovës, rezulton se mungon kompetenca lëndore dhe territoriale e kësaj gjykate që të shqyrtoj një kontest civil-juridik ndaj të paditurit “Digit Alb” Sh.A., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, përderisa ky i fundit nuk ka asnjë lidhshmëri me territorin e Republikën e Kosovës.

Gjykata tutje gjeti se në rastin konkret nuk plotësohen kushtet për themelimin e kompetencës së kësaj gjykate as nga neni 115 i Ligjit nr.08/L-028 për të Drejtën Ndërkombëtare Private e cila përcakton se *“Nëse në territorin e Republikës së Kosovës ka ndonjë pasuri të të paditurit, gjykata e Republikës së Kosovës është kompetente kur paditësi ka vendbanim, përkatësisht seli në Republikën e Kosovës, dhe nëse: 1.1. vlera e pasurisë nuk është joproporcionale me kërkesën; 1.2. kontesti ka lidhje të mjaftueshme me Republikën e Kosovës.”*, kjo pasi që në rastin konkret, paditësi nuk ka evidentuar në padi ndonjë pasuri të të paditurit e cila gjendet në territorin e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, gjykata gjeti se në rastin konkret nuk vie në shprehje aplikimi i dispozitave nga neni 123 i Ligjit i cili përcakton se *“Për çështje me element ndërkombëtar për të cilat sipas të drejtës së Republikës së Kosovës palëve u lejohet të disponojnë me të drejtat e veta, palët mund të merren vesh për kompetencën e gjykatës të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e kontestit që ka lindur ose mund të lindë nga marrëdhënia konkrete juridike”* meqenëse në rastin konkret, mungon marrëveshja formale e arritur mes palëve lidhur me kompetencën e gjykatave në Republikën e Kosovës për zgjidhjen e kontesteve eventuale mes tyre. Ndërsa, fakti që sipas nenit 11 të kontratës së reklamimit të datës 10.10.2015 të lidhur në mes paditësit dhe subjektit Agency One LLC është përcaktuar se kompetente për trajtimin e kontesteve është Gjykata në Republikën e Kosovës nuk i jep kompetencë lëndore kësaj gjykate në trajtimin e kësaj çështje kontestimore meqenëse në rastin konkret, si i paditur figuron Digit Alb Sh.A me seli në Republikën e Shqipërisë dhe i cili subjekt, nuk është palë nënshkruese e kontratës së reklamimit të datës 10.10.2015.

Andaj, në mbështetje të nenit 18 par.3 të LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata gjatë zhvillimit të procedurës konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata e vendit, do të shpallet inkompetente, do t’i anulojë veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë*

poshtë padinë. Mirëpo, gjykata nuk do të veprojë ashtu nëse kompetenca e gjykatës së vendit tonë varet nga pëlqimi i të paditurit, e i padituri e ka dhënë pëlqimin e vet” gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata pati parasysh pretendimin e palës paditëse se i padituri, ka mundur që ta kontestoj mungesën e kompetencës lëndore me përgjigje në padi, apo më së largu në seancën përgatitore, gjë të cilën nuk e ka bërë, por që këtë pretendim, gjykata e vlerësoi si të paqëndrueshëm pasi që gjykata, ka për detyrë që të bëj vlerësimin e kompetencës gjyqësore dhe asaj lëndore gjatë gjithë procedurës dhe atë sipas detyrës zyrtare, kjo në mbështetje të nenit 18 par.1 të LPK-së i cili përcakton se “Gjykata, sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore”.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 298/22, datë 23.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.